




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Deçanit (KD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpalosjet e pasurive në PFV nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin nënvlerësuar për 6,477,610€;
- B2 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 625,259€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Prej tyre, 461,909€ ishin pagesa që janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore dhe 163,350€ ishin pagesa që janë kryer nga komuna si rezultat i keq buxhetimit;
- B3 Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin mbivlerësuar për 561,043€;
- B4 Mangësi në shpalosjen e detyrimeve të papaguara në PFV;
- A1 Komuna ka ekzekutuar pagesa nga subvencionet në vlerë 16,700€ te stafi i angazhuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MShV) në emër të kërkesave të personave tjerë.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Deçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Mos aplikimi i drejtë i kushteve ligjore për vlerësimin e tenderëve si jo normalisht të ulët;
- B5 Tejkallim i sasive të kontraktuara mbi 30% e lejuar për kontratat publike kornizë;
- B6 Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme;
- B7 Mangësi në shpërndarjen e subvencioneve për organizatat jo qeveritare - OJQ;
- A3 Ndarja e bursave në kundërshtim me kushtet e konkursit publik;
- B8 Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara nga Thesari;
- B9 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë;
- B10 Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Deçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Deçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Deçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Deçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Deçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim rreth menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në komunë ishte përcjellur me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PFV-ve. Pas kërkesës sonë, pasqyrat janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA dhe disa nga çështjet e ngritura nga ne janë korrigjuar. Mirëpo, gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në shpalosjen e pasurive, detyrimeve kontingjente, ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 17 rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja dhe 14 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mangësi në regjistrat e pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që: “çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, sipas nenit 6.3: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria”.

Kemi identifikuar se komuna nuk kishte bërë regjistrimin e pasurive të blera gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022. Rrjedhimisht, regjistri i pasurive kapitale mbi 1,000€ ishte nënvlerësuar për 6,152,406€ pasi që pagesat e shpenzimeve kapitale (ndërtim i rrugëve, shpronësime, mirëmbajtje investive etj.) nuk ishin regjistruar në SIMFK. Pasuria jo kapitale nën 1,000€ ishte nënvlerësuar për 325,204€, pasi që blerjet e mallrave, mobileve dhe pajisjeve të ndryshme nuk ishin regjistruar në E-pasuria. Ndërsa, për shkak të mungesës së zyrtarit të pasurive, nuk na është ofruar dokumentacioni i dëshmive burimore për mostrat e përzgjedhura nga regjistri i pasurive me bazë nga vitet paraprake.

Po ashtu, çështjet e ngritura në raportin e vitit të kaluar janë bartur edhe në vitin 2022, përkatësisht:

- Pronat e komunës (toka) ende nuk janë të regjistruara në regjistrat kontabël;
- Objekti i shkollës fillore “Edmond Hoxha” nuk i takon Komunës së Deçanit por asaj të Junikut ndërsa ende figuron në regjistrat e pasurisë kapitale duke e mbivlerësuar pasurinë kapitale bruto për 256,660€;
- 22 vetura të llojeve të ndryshme të cilat janë të vjetra dhe vlera e tyre

në libra do duhej të ishte zero, nuk janë zhvlerësuar fare duke mbivlerësuar pasurinë kapitale neto për 70,615€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrollit të brendshëm. Përderisa sipas arsyetimeve të komunës, kjo gjendje ishte për shkak të daljes në pension të zyrtarit të pasurive dhe pa mundësisë së zhvillimit të procedurave të rekrutimit për mbulimin e kësaj pozite. Megjithatë, gjatë auditimit, jemi njoftuar se tashmë është rekrutuar zyrtari i pasurisë.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe ka rezultuar në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në një rën anë dhe departamentit të financave në anën tjetër për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Keq klasifikim i shpenzimeve

Gjetja

Udhëzimi administrativ Nr. 19/2009 për planin kontabël, nenit 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 461,909€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe me borxhet ndaj furnitorëve të ndryshëm, përkatësisht:

- Nga investimet kapitale ishin paguar 110,197€ për paga dhe shujta që kanë buruar nga obligimet e kontratave kolektive. Tutje, nga investimet kapitale ishin paguar 222,895€ për mallra dhe shërbime lidhur me borxhet ndaj furnitorëve. Po ashtu, nga investimet kapitale ishin paguar edhe 118,831€ për subvencione lidhur me obligimet e marra ndaj përfituesve të subvencioneve.
- Nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 8,574€ për investime kapitale lidhur me borxhet ndaj furnitorëve si dhe 1,412€ për paga dhe mëditje.

Po ashtu, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 163,350€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë kryer nga komuna si rezultat i keq buxhetimit dhe gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve të shkaktuar nga vet komuna dhe kanë të bëjnë me borxhet ndaj furnitorëve të ndryshëm si dhe me obligimet e marra nga marrëveshjet për subvencionimin e projekteve të ndryshme, përkatësisht:

- Nga investimet kapitale ishin paguar 39,865€ për mallra dhe shërbime ngase pagesa ishte për furnizim me pajisje të teknologjisë informative (vlera e pajisjeve për njësi është nën 1,000€) për stafin e

- komunës;
- Nga mallrat dhe shërbimet komuna ka paguar 35,000€ për subvencione dhe transfere, bazuar në Memorandumin e mirëkuptimit mes komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale Higjiëna dhe Asociacionit për mbrojtjen e ambientit dhe pastrimit të Kosovës, dhe ka për qëllim implementimin e programit për digjitalizim, standardizim dhe sigurim të cilësisë së shërbimeve të kompanisë publike. Për më tepër komuna nuk kishte zhvilluar as një procedurë për subvencionim, si dhe kjo çështje nuk ishte trajtuar nga Kuvendi Komunal;
 - Nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 59,808€ për subvencione dhe transfere, pagesa ishte për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës;
 - Po ashtu, nga mallrat dhe shërbimet komuna ka paguar 28,677€ për subvencione në bazë të një kërkesë nga NPL “Higjiëna”, (aksionare e të cilës është komuna) që ti ndihmonte në kryerjen e obligimeve që kishte kompania ndaj Kompanisë tjetër publike KRM “Ambienti”.

Keq klasifikimet e shpenzimeve kanë ndodhur si pasojë e pagesave të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore, për shkak të planifikimit të dobët të buxhetit dhe gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve të shkaktuar nga vet komuna si dhe mos aprovimit të kërkesave buxhetore të komunës nga MFPT.

Ndikimi Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, rrjedhimisht mund të shpie në keqkuptim të aktivitetëve financiare të komunës.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente në PFV

Gjetja Sipas Nenit 18 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore: “Organizatave buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente”.

Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishin të plota dhe të sakta, ngase ishin mbivlerësuar për 561,043€. Në këtë vlerë, kemi vërejtur se në regjistrin e Detyrimeve kontigjente janë përfshirë lëndë të cilat me vendime gjyqësore janë ekzekutuar 27 pagesa në vlerë 183,023€. Po ashtu, në këtë regjistër janë përfshirë edhe 305 lëndë në vlerë 378,019€, të cilat kanë vendim të plotfuqishëm nga gjykata, pa prapsim nga komuna dhe pritet ekzekutimi i pagesave nga Thesari, pra janë obligime të pa paguara dhe rrjedhimisht shpie në nënvlerësimin e obligimeve të pa paguara për këtë shumë.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, ngase kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportin e vitit paraprak. Ndërsa sipas përfaqësuesit ligjor të komunës, kjo gjendje ishte për shkak të angazhimit të madh në seanca gjyqësore.

Ndikimi Mos shpalosja e saktë e detyrimeve kontigjente ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre dhe mund të shpie në keqkuptimin e aktiviteteve financiare të komunës. Rrjedhimisht kjo, së bashku me gabimet tjera ka ndikuar në opinionin e auditimit.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në nënvlerësimin e detyrimeve kontigjente për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në shpalosjen e detyrimeve të papaguara në PFV

Gjetja Neni 17 i Rregullores Nr. 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore ndër të tjera përcakton Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Kemi evidentuar se shpalosjet e detyrimeve (faturave) të papaguara për vitin 2022 nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin nën vlerësuar për 418,200€.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes sektorit të financave dhe menaxherëve të kontratave të cilët nuk bënë me kohë dorëzimin e faturave të pranuar.

Ndikimi Mos shpalosja e plotë dhe e saktë e detyrimeve të papaguara ka ndikuar në nën/mbivlerësimin e tyre dhe mund të shpie në keqkuptimin e aktiviteteve financiare të komunës. Rrjedhimisht kjo, së bashku me gabimet tjera ka ndikuar në opinionin e auditimit.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në gabimet e shpalosjeve për detyrimet e papaguara dhe të sigurojë se të gjitha faturat pranohen përmes arkivit të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mangësi në ekzekutimin e pagesave për subvencione dhe transfere

Gjetja Rregulla financiare 01/2013 për Shpenzimin e parasë publike ka përcaktuar rregullat dhe kriteret e ekzekutimit të pagesave, në veçanti neni 36 i kësaj rregullore, ka vendosur rregullat e ekzekutimit të pagesave për subvencione dhe transfere.

Komuna ka ekzekutuar pagesa nga subvencionet në vlerë 16,700€ te stafi i angazhuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MShV) në emër të kërkesave të personave tjerë. Nga verifikimi i pagesave kemi evidentuar se ato ishin pagesa në emër të kërkesave të palëve tjera të cilat kryesisht kishin të bënin me përkrahjen e rasteve të sëmundjeve si dhe ato me kushte të renda socio-ekonomike. Vendimet Kryetarit për subvencionimin e këtyre rasteve specifikojnë se mjetet financiare do të transferohen te stafi i angazhuar përmes MShV-ve sipas marrëveshjeve mes palëve (të cilët ishin

si të afërm). Jemi njoftuar se këto marrëveshje ishin vetëm verbale.

Shkaku i kësaj gjendje sipas komunës ishte vonesa e regjistrimit të furnitorëve të riinjë e shkaktuar nga Ministria e Financave për shkak të një rifreskimi të bazës së furnitorëve në gjithë Republikën e Kosovës dhe urgjencës së përkrahjes në kërkesat e qytetarëve për subvencionim.

Ndikimi

Pagesat për dhe në emër të personave tjerë nuk japin siguri se mjetet financiare shkojnë në destinimin e synuar dhe rrjedhimisht mund të rezultojë në keqpërdorimin e buxhetit të komunës.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për tu siguruar që mjetet e paguara për këto qëllime kanë shkuar në destinimin e synuar si dhe të forcojë kontrollet në ekzekutimin e pagesave për tu siguruar se nuk do të përsëriten rastet e tilla.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mos aplikimi i drejtë i kushteve ligjore për vlerësimin e tenderëve si jo normalisht të ulët

Gjetja

Neni 3.1 i Rregullores për tenderët jo normalisht të ulët ka përcaktuar se autoritet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik (OE) për të shpjeguar çmimin e ofruar kur të përmbushën të gjitha kushtet si në vijim: 1. janë dorëzuar të paktën tre tenderë; 2. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; si dhe 3. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Te procedura e prokurimit “Meremetimi dhe inventarizimi i objektit shtëpia alpine bjeshkatore Shkëlzen Haradinaj”, kemi evidentuar se nga tre operator të cilët ishin vlerësuar si të përgjegjshëm, dy më të lirët ishin refuzuar me arsyetimin se ofertat e tyre ishin vlerësuar si tender jo normalisht të ulët. Refuzimi i tyre kishte ndodhur pasi që OE nuk janë përgjigjur në kërkesën e zyrës së prokurimit për të shpjeguar çmimin e ofruar, ngase sipas komisionit vlerësues, çmimi i ofruar ishte më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët. Mirëpo, vlerësimi ofertave si tender jo normalisht të ulët nuk ishte në pajtim me kushtet e nenit 3.1 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, ngase nuk i plotësonte dy nga tre kushtet e përcaktuara për cilësimin e tenderëve si jo normalisht të ulët. Përkatësisht tenderët e refuzuar nuk plotësonin kushtet se: çmimi i ofruar ishte më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; e as më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Oferta me e lirë ishte në vlerë 335,925€, ndërsa kontrata e nënshkruar është në vlerë 386,224€, apo 50,299€ më shtrenjtë.

Sipas arsyesimit të zyrës së prokurimit, refuzimi i tenderëve ka ndodhur për shkak të mos përgjigjes nga ana e OE në kërkesën e komunës për sqarimin e çmimeve/ofertave të dorëzuara. Ndonëse ne kemi vërejtur mungesë të njohurive lidhur me kërkesat ligjore të prokurimit publik nga stafi i angazhuar në vlerësimin e ofertave.

Ndikimi

Mos aplikimi i drejtë i kushteve për vlerësimin e tenderëve si jo normalisht të ulët, ka rezultuar në dëmtim të buxhetit të komunës, ngase oferta e shpërblyer me kontratë është për 50,299€ më shtrenjtë se oferta më e lirë.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të shtojë kontrollet në zyrën e prokurimit për të siguruar se stafi i caktuar në menaxhimin e procedurave të prokurimit janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik dhe se aplikojnë kontrollet në të gjitha fazat e tij.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Tejkalim i sasive të kontraktuara mbi 30% e lejuar për kontratat publike kornizë**Gjetja**

Sipas Udhëzuesit për prokurimin publik, pika 56 Kontrata Kornizë pika 10-Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqindje (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Nga testimi i pagesave të kontratës publike kornizë "Mirëmbajtja verore dhe dimërore në rrugët e komunës së Deçanit" prej 1,933,111€, kemi vërejtur tejkalim të sasisë së kontraktuar mbi 30% e lejuar. Tejkalim të sasive kishte në shtatë (7) pozicione në vlerë totale prej 460,953€.

Po ashtu, te kontrata "Programi për energji eficiente në Komunën e Deçanit" prej 342,923€, kemi vërejtur tejkalim të sasisë së kontraktuar mbi 30% e lejuar. Tejkalim të sasive kishte në 54 pozicione në vlerë totale prej 25,943€.

Tejkalimi i sasive të kontraktuara mbi 30% e lejuar ishte bërë me aprovimin e Kryetarit të Komunës me arsyetimin e mundësimin të kompletimit të projekteve sipas specifikave dhe nevojave të hasura në teren gjatë realizimit tyre.

Ndikimi

Mospërputhshmëria ndërmjet situacioneve të punëve të realizuara dhe specifikacionit të kontratës krijon paqartësi lidhur me nevojat reale për punë dhe ndikon në zbatimin e drejtë të kontratës sipas kushteve kontraktuale dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po ashtu duhet të sigurojë se projektet e specifikuara nuk tejkalojnë paramasën e përlogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme**Gjetja**

UA Nr. 01/2018 neni 7, Ligji i punës 03/L-212 neni 10 paragrafi 6 Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë (120) ditë brenda një (1) viti, Ligji për Zyrtaret Publik Nr.06/L-114 neni 84 Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Gjatë vitit Komuna kishte angazhuar 113 punonjës përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV), prej tyre 55 në administratën komunale në drejtori të ndryshme, 54 në shëndetësi si dhe katër (4) në arsim. Për këta punonjës komuna nuk ka zhvilluar as procedurë formale të rekrutimit as procedura të prokurimit për MShV, por janë angazhuar me vendime të kryetarit të komunës. Për 91 punonjës kishte vendim për kohë të caktuar gjashtë (6) muaj, ndërsa 22 tjerë kishin vendim deri në përfundim të mandatit të kryetarit.

Angazhimi i tyre nuk është bërë për shërbime të veçanta apo detyra specifike por për pozita të rregullta të punës. Për këta punonjës komuna në vitin 2022 ka paguar 323,288€.

Sipas zyrtarëve komunal angazhimi i stafit pa procedura ka ndodhur për shkak se kanë mungesë të punëtorëve dhe pamundësisë së zhvillimit të procedurave të rekrutimit si dhe nevojave për mbulimin e pozitave pas pensionimit të disa punonjësve. Ndonëse duhet theksuar se kjo çështje trajtohet në vazhdimësi në raportet e auditimit.

Ndikimi

Emërimi i zyrtarëve në pozita të rregullta për periudhë të caktuar dhe angazhimi me kontrata për një detyrë specifike me afat më të gjatë sesa parashihet si dhe këshilltarëve pa procedura është në kundërshtim me legjislacionin përkatës. Njëherit kjo rrit rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për pozita të caktuara duke eliminuar konkurrencën dhe mundësitë e barabarta për punësim.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MShV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mangësi në shpërndarjen e subvencioneve për organizatat jo qeveritare - OJQ**Gjetja**

Rregullorja Nr.04/2017, neni 1 përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të organizatave jo-qeveritare (këtu e tutje OJQ), me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve të OJQ-ve që janë të interesit publik të në Republikën e Kosovës. Po ashtu sipas nenit 12, çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare dhe formave tjera për njoftim të OJQ-ve me qëllim të rritjes së konkurrencës.

Nga testimi i subvencioneve për financimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e kulturës, kemi identifikuar se nuk aplikohen procedurat e thirrjes publike për përzgjedhjen e përfituesve. Përkatësisht, gjatë vitit 2022, komuna kishte subvencionuar 11 OJQ pa thirrje publike në vlerë prej 24,200€. Për më tepër komuna sipas nenit 22 dhe 23 të rregullores 04/2017 nuk kishte lidhur/nënshkruar ndonjë kontratë/marrëveshje me përfituesit e subvencioneve ku do të cekej mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, raportimi dhe monitorimi.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Ndarja e subvencioneve pa thirrje publike ndikon në transparencë dhe në uljen e konkurrencës, po ashtu mos nënshkrimi i marrëveshjeve/kontratave me përfituesit e subvencioneve rritë rrezikun që mjetet buxhetore të ndahen dhe shpenzohen në kundërshtim me objektivat e Komunës.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu, me rastin e ndarjes së subvencioneve të lidhë marrëveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Ndarja e bursave në kundërshtim me kushtet e konkursit publik****Gjetja**

Konkursi publik i dt. 19.08.2021 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Deçanit për vitin akademik 2019-2020 ndër të tjera ka përcaktuar kushtet për konkurrim si: të jetë studentë i rregullt në ndonjërin nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës, të jetë studentë i nivelit Bachelor i vitit të dytë e më lartë etj. Në kushte të barabarta përparësi kishin fëmijët e dëshmoreve, personat me nevoja te veçanta, asistencë sociale etj. Vlera e bursës komunale për studentë ishte 300€ në vit.

Nga testimi i thirrjes publike për ndarjen e bursave, kemi evidentuar tre (3) përfitues të bursave të cilët nuk plotësonin kriteret e përcaktuara me thirrje publike. Përderisa dy (2) prej tyre nuk ishin studentë të nivelit Bachelor ngase kishin diplomuar në kohën kur aplikonin për burs, njëri prej tyre kishte qenë i angazhuar si punëtor i komunës përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçanta gjatë vitit 2020/2021 si dhe ishte studentë edhe në një kolegji privat. Duhet theksuar se të tre këta kishin përfituar bursat përmes

ankesave në procesin e vlerësimit të aplikuesve.

Sipas sqarimeve të zyrtareve komunal, aprovimi i ankesave ishte për shkak se dhënia e bursave ishte bërë për herë të parë nga komuna dhe thirrja është hapur për vitin akademik 2019/2020 ku në këtë periudhë ata ishin studentë ndërsa për rastin e tretë ishte për shkak të kushteve të rënda ekonomike.

- Ndikimi** Dhënia e bursave për studentë të cilët nuk plotësonin kushtet e konkursit publik paraqet diskriminim, nuk arrin qëllimin e synuar të subvencionimit të bursave si dhe mund të ndikojë në dekurajimin e studentëve meritore për të marrë pjesë në konkurset e ardhshme.
- Rekomandimi A3** Kryetari duhet të shtojë kontrollet në procesin e vlerësimit të aplikuesve për ndarjen e subvencioneve komunale për të siguruar se përfitojnë vetëm ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara nga Thesari

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2022 kishte kryer pagesa në vlerë prej 2,156,052€ apo 1,693 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor. Vonesat variojnë nga 1 deri në 961 ditë.

Po ashtu, në bazë të vendimeve gjyqësore, Thesari kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej 1,406,368€. Kjo formë e pagesave, përveç ndikimit në keq klasifikimin e shpenzimeve, ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve, ngase borxhi kryesor ndaj pretenduesve ishte 1,250,038€ ndërsa shpenzimet tjera procedurale ishin 156,330€.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor dhe njëherit realizimin e pagesave me vendime gjyqësore/përmbarimore.

- Ndikimi** Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbarimit ka ndikuar në rritjen e kostos për komunën.
- Rekomandimi B8** Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B9 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë**Gjetja**

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton: 11.4 4. Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimin të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- Për 887 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 - “Zbritjet për vendbanim parësor”, mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezultojnë më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 19,957€.
- Për më tepër, në kuadër të 887 tatimpaguesve tek të cilët është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, janë 737 tatimpagues për të cilët nuk ishte përcaktuar kategoria e pronës.

Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake dhe për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë nuk është arritur që të azhurnohen të dhënat në Protax.

Ndikimi

Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përlogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit. Pastaj të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B10 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve****Gjetja**

Sipas nenin 15 të pikës 2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Nga 10,441 objekte të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna ka regjistruar 75 prona të reja, si dhe kishte arritur të verifikoj vetëm 16 nga të gjitha pronat apo më pak se 1%. Përqindja shumë e ulët e inspektimit, tregon se komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e kësaj situate, megjithëse rekomandimi është përsëritur.

Sipas zyrtarëve, inspektimi jo i plotë kishte ndodhur për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2022 ishin 689,783€ apo rreth 3% më pak se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja B11 - Ankesa nga tatimpaguesit për vlerësimin e gabuar të pronave

- Gjetja** Sipas “Ligjit nr. 06/L-005 neni 12, paragrafi 2, çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Sipas këtij paragrafi ndër përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim: regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme. Po ashtu, sipas nenit 31 pika 6 “Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar me një vendim të arsyetuar”.
- Lidhur me trajtimin e ankesave të tatimpagueseve për vendosje të gabuar të tatimit në pronë kemi identifikuar se nga gjithsej 46 ankesa për vlerësimin jo të duhur të pronave, vetëm 5 (pesë) prej tyre janë refuzuar ndërsa pjesa tjetër e ankesave janë pranuar si të bazuara. Kjo tregon për nivelin e theksuar të gabimeve në bazën e të dhënave.
- Kjo ka ndodhur për shkak të stafit të limituar në sektorin e tatimit në pronë si dhe komunikimit të pa mjaftueshëm ndërmjet komunës dhe Ministrisë së Financave.
- Ndikimi** Mos azhurnimin i informatave dhe vlerësimi jo i duhur i pronave në bazën e të dhënave të tatimit në pronë, mund të ndikoj në vështirësi në arkëtimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe rritjen e llogarive të arkëtueshme si pasojë e pakënaqësisë dhe ankesave të qytetarëve.
- Rekomandimi B11** Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollat që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 14,612,547€, pasurive jokapitale është 80,342€ si dhe e stoqeve 46,114€.

Çështja B12 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bërë fare vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të nenit 20 dhe 21 të Rregullores 02/2013 që ka të bëjë me vlerësimin e pasurive të dëmtuara, vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurive si dhe përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B12 Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,501,524€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë si dhe qiratë.

Çështja B13 - Menaxhimi jo efektiv i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Neni 26 i Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, përcakton se: "Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe sipas nenit 27: Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori".

Komuna nuk ka ndërmarr masa të mjaftueshme ligjore dhe nuk ka menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe si rrjedhojë vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2022 ishin 2,501,524€ dhe krahasuar me vitin paraprak rritja totale e të arkëtueshmeve ishte për 404,979€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në prone, ku borxhi total është euro 2,488,336€ (nga të cilat për objekte ishin 1,745,704€, përkatësisht për parcela 742,623€), si dhe qiratë 13,188, të cilat nuk kanë fare ndryshim nga viti i kaluar.

Rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre, ndonëse sipas zyrtarëve të komunës këtu ka ndikuar edhe heqja e detyrimit për pagesën e tatimit në pronë me rastin e pagesës së taksës për regjistrimin e automjeteve.

Ndikimi Mos zbatimi i mekanizmave të përcaktuar me ligj dhe rregullore përkatëse ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde më të pakta për arritjen e synimeve dhe mund të ndikoj edhe tek debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi B13 Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte drejtorin dhe një anëtar. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë pesë (5) auditime të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit 2022. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 41, prej të cilave të zbatuara ishin 19, në proces ishin 11 dhe 11 të pazbatuara. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, rishikimin e proceseve të shpenzimeve, inkasimin e llogarive të arkëtueshme, menaxhimin e personelit si dhe menaxhimin e kontratave, përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2022. Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur katër (4) takime, ku ishte diskutuar për punën dhe raportet e NjAB-së

Çështja B14 - Mungesa e planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të NjAB-së

Gjetja Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.

Po ashtu, sipas Rregullores 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e auditimit të brendshëm neni 9, pika 7 - Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. Gjithashtu sipas nenit 10 pika 1.3 të së njëjtës rregulloreje - Është përgjegjësi e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për auditimin e brendshëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve për të cilat janë pajtuar për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

NjAB në Komunën e Deçanit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar, e që duhet të ketë së paku tre auditorë.

Në anën tjetër, njësitë e audituara nuk kishin përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm. Si rrjedhojë, rekomandimet e AB-së nuk ishin adresuar sa duhet nga menaxhmenti, ku 11 nga 41 rekomandimet e dhëna për vitin 2022 nuk ishin adresuar.

Kjo gjendje ishte për shkak mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore. Ndërsa mungesa e planeve për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së ishte për shkak të neglizhencës dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës të drejtorive përkatëse.

Ndikimi Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik. Ndërsa, mungesa e planit të veprimit dhe ndërmarrja e veprimeve të pamjaftueshme nga menaxhmenti në adresimin e rekomandimeve mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuar, jo efikasitet në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B14 Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. Po ashtu, duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	10,649,355	11,245,324	10,801,693	9,785,496	9,845,911
Grante Qeveritare - Buxheti	9,617,646	9,776,628	9,713,779	9,098,298	9,090,915
Financimi përmes huamarrjes	0	94,003	94,003	32,434	91,161
Të bartura nga viti i kaluar	0	324,434	322,938	112,052	241,946
Të hyrat vetanake	1,031,709	1,031,709	669,476	530,712	421,890
Donacionet vendore	0	18,498	1,496	12,000	0
Donacionet e jashtme	0	52	0	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 595,969€. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së grantit të qeverisë për 158,982€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 324,434€, rritjes së donacioneve të brendshme për 17,524€, rritjes së financimit nga huamarrja prej 94,003€ si dhe donacioneve të jashtme për 1,026€.

Në vitin 2022 OB ka shpenzuar 96% të buxhetit final, me një rritje prej rreth 10% në krahasim me vitin 2021.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	10,649,355	11,245,324	10,801,693	9,785,496	9,845,911
Pagat dhe mëditjet	5,698,340	5,957,648	5,934,913	5,779,575	5,533,458
Mallrat dhe shërbimet	1,694,536	1,874,737	1,844,173	1,619,414	1,562,168
Komunalitë	156,000	196,000	195,491	154,906	155,000
Subvencionet dhe transferet	160,000	160,428	152,100	172,625	115,821
Investimet Kapitale	1,812,000	3,056,511	2,675,016	2,058,976	2,479,464
Rezervat	1,128,479	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 259,308€. Rritja ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë prej 252,985€ për të mundësuar harmonizimin e ndarjeve buxhetore të kategorisë së pagave dhe shtesave si dhe rritjes nga të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 6,323€;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 180,201€. Rritja ishte nga të hyrat e bartura për 177,683€ si dhe nga donacionet prej 2,518€; si dhe
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,244,511€. Rritja ishte nga të hyrat e bartura për 100,000€, nga donacionet për 16,032€ si dhe nga kategoria e Rezervës 1,128,479€ për financimin e 11 projekteve kapitale për vitin 2022.

Sipas të dhënave në SIMFK, shpenzimet gjatë vitit 2022 për projektin 00098 ishin 94,003€. Ato janë realizuar nga Programi për rimëkëmbje ekonomike dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave të stafit (në sektorin e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe sektorin e arsimit) sipas vendimeve të nivelit qendror.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2022 ishin 689,783€ apo rreth 3% më pak se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	1,031,709	1,031,709	689,783	712,376	409,922
Të hyrat tatimore	804,112	804,112	387,433	473,002	232,312
Të hyrat jo tatimore	227,597	227,597	302,350	238,124	177,610
Të hyrat tjera	0	0		1,250	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Mirëpo, komuna nuk ka raportuar me kohë lidhur me zbatimin e rekomandimeve përmes raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve të cilat ishte dashur të dorëzoheshin me 30.09.2022 dhe 15.03.2023. Deri në fund të auditimit për vitin 2022, një (1) rekomandim është zbatuar, ndërsa për 14 rekomandime nuk ka filluar zbatimi, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërën anë dhe departamentit të financave në anën tjetër për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit, për të siguruar se informatat lidhur me të hyrat janë të plota dhe të sakta në PFV.	Edhe në këtë vit kemi evidentuar mangësi në shpалosjen e të dhënave në PFV.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Të hyrat	Kryetari i Komunës të sigurojë, bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Sektorit Komunal të Tatimit në Pronë dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Verifikimi i 20% të pronave nuk është arritur as në vitin 2021.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MSHV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësit kërkuese.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme që mjetet e paguara më tepër të kthehen në buxhetin e komunës si dhe të forcojë kontrollet në menaxhimin e kontratave dhe ekzekutimit të pagesave për tu siguruar se nuk do të përsëriten rastet e tilla.	Çështja ishte trajtuar nga ana e komunës dhe ky rekomandim është zbatuar.	I zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu, me rastin e ndarjes së subvencioneve të lidhë marrëveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po ashtu duhet të sigurojë se projektet e specifikuara nuk tejkalojnë paramasën e përlogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme ngase edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme ngase edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë veprime të mjaftueshme në këtë drejtim ngase edhe në këtë vit ka vazhduar rritja e tyre.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në nënvlerësimin e detyrimeve kontingjente për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.	Edhe këtë vit kemi evidentuar se ishte bërë nënvlerësimi i detyrimeve kontingjente.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. Po ashtu, duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,


Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Deçanit, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Bashkim Ramosaj

Kryetar i Komunës

Data: 24 prill 2023, Deçan



Z. Kjetant 12175
02 24.04.23

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.